

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2679/1 datë 10.06.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3053/4 datë 18.07.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 29-të mbajtur më 17.07.2024, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e kryer nga neni 51 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor të transmetuar më 28 maj 2024, nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion shfrytëzuesve.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2679/1 datë 10.06.2024, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shoje nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave nga aspekti i pajtueshmërisë së veprimtarisë së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, LSHMAAV dhe Rregulloret e miratuara në bazë të ligjit.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë vërejtje publike në rastet kur konstatohet mosrespektim, shkelje ose cënim i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pikën 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, është përcaktuar se për shkeljet e konstatuara në vitin aktual, për të cilat janë shqiptuar masat në vitin paraprak, Këshilli i Agjencia sërish do të shqipton masë vërejtje publike sipas afateve të përcaktuara në Udhëzim.

Në pajtim me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele duhet t'u ofrojnë shfrytëzuesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme të paktën për të dhënat në vijim: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual, gjegjësisht emrin, emërtimin, markën tregtare ose shenjën e shkurtuar të identifikimit (avizo, logo, etj.); adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel; të dhëna për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio ose audiovizuel (numër telefoni, e-mail adresë dhe/ose ueb-faqje, personin për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundur, dhe të trupit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 10 qershor 2024, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR-TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, transmetuar më 28 maj 2024, në nivel lokal, ku u konstatua se transmetuesi nuk ka vepruar sipas aktvendimit për shqiptimin e masës - vërejtje publike PA1 nr.03-366, datë 24.11.2023, gjegjësisht nuk e ka mënjanuar shkeljen e kryer të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Gjegjësisht, nga mbikëqyrja u konstatuar se më 28 maj 2024, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion shfrytëzuesve, gjegjësisht nuk ka ofruar qasje të

lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme për të dhënat në vijim: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatic audiovizuel; adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatic audiovizuel; të dhënat për kontakt (numër, e-mail adresë dhe/ose të ueb-faqes; personin përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe të trupit rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2676/1 datë 10.06.2024, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë me datë 11.06.2024, ka dërguar Shkresë ark.nr.10-2676/2 datë 11.06.2024, ku i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2676/1 datë 10.06.2024, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. E njëjta, më 13.06.2024 dhe më datë 04.07.2024, është dërguar në mënyrë elektronike në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit, regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV dhe në regjistrin e transmetuesve të mbajtur nga Agjencia. Duke pasur parasysh se pas dy tentimeve për pranim të shkresës ark.nr.10-2676/2 datë 11.06.2024, drejtuar Agjencisë nuk ka ardhur letër kthyesë nga SH.A. Posta e RMV-së, Agjencia ka kryer kontroll në sistemin elektronik – ndjekjen e dërgesave të SH.A. Posta e RMV-së (përmes së cilës kontrollohet statusi i dërgesës), nga ku u konstatua se shkresa në fjalë ishte dorëzuar /adresuar në mënyrë të rregullt te transmetuesi më 27.06.2024. Në afatin e parashikuar, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 17.07.2024, pasi shqyrtoi lëndën Raporti me shkrim dhe konkludoi që SHTR GURRA SHPKNJP Kërçovë t'i shqiptohet masë - vërejtje publike .

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pikat 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2676/1 datë 10.06.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3053 datë 18.07.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 17.07.2024, miratoi Aktvendim që paralajmëron publikisht SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2676/1 datë 10.06.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.